

Shoqeria "VARAKU E" sh.p.k.
Durrës

V E N D I M
I
ORTAKUT TE VETEM

Nr.3 date 28.06.2014

Ortaku i Vetem, ne cilesine e Asamblese se Pergjitheshme, i Shoqerise "VARAKU E" sh.p.k. XHafzotaj, Durrës, mori ne analize Pasqyrat Financiare te Shoqerise per vitin ushtrimor financiar te mbyllur me 31.12.2013 dhe ne perfundim te saj, mbeshtetur ne statutin e shoqerise, ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" vecanerisht ne nenin 81 e ne vijim,

Vendosi:

1- Miratimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise per vitin financiar te mbyllur me 31.12.2013.

2- Fitimi i ushtrimit ne masen 27.995.089 leke te perdoret:

a-Devident per t'u shperndare	5.000.000 leke
b-Per zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise	20.000.000 leke
c-Per rritjen e rezervave ligjore	2.000.000 leke
d-Mbeten per rezerva te tjera	995.089 leke

4- Zmadhimin e kapitalit aksionar te shoqerise ne masen 20.000.000 leke.

5-Caktimin, sipas ligjes, te z. Azem Hykaj, Ekspert Kontabel i Autorizuar dhe i Regjistruar i shoqerise per te bere "Vertetimin e kontributeve financiare per mundesine e zmadhimit e kapitalit aksionar (themeltar) te shoqerise me mjetet e veta financiare".

Mbi bazen e ketij vendimi te behen ndryshimet e duhura ne kontabilitetin e shoqerise, te informohen institucionet e duhura dhe te kryhen procedurat per zmadhimin e kapitalit sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

Ortaku i Vetem Themelues i Shoqerise

Shpetim VARAKU



Shoqeria "VARAKU E" Sh.P.K.
Durrës

V E N D I M
I
ORTAKUT TE VETEM

Nr.4 date 10.07.2014

Ortaku i Vetem themelues, ne cilesine e Asamblese se Pergjitheshme, i Shoqerise "VARAKU E" sh.p.k. Xhafzotaj, Durrës pasi u njoh me raportin e z. Azem Hykaj, ekspert kontabel i regjistruar i shoqerise, mbeshtetur ne kerkesat e statutit te shoqerise dhe te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret e shoqerite tregetare",

Vendosi:

1-Miratimin e raportit te z.Azem Hykaj, ekspert kontabel i regjistruar i shoqerise "Mbi mundesine e zmadhimit te kapitalit aksionar me mjetet e veta financiare".

2-Kapitali aksionar (themeltar, i shoqerise te zmadhohet 20.000.000 leke nga fitimet e vitit 2013, gjendje financiare ne kapitalin e shoqerise.

Pas zmadhimit, kapitali aksionar nga 185,000.000 leke behet 205.000.000 leke.

3-Perqindjet e kuotave qe zoteron ortaku ne kapitalin aksionar (themeltar) te nenshkruar te shoqerise nuk ndryshon edhe pas zmadhimit te tij.

Mbi kete baze te behen ndryshimet e duhura ne kontabilitetin e shoqerise dhe te informohen institucionet e duhura sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

Ortaku i Vetem Themelues i Shoqerise

Shpetim VARAKU

